




Republika Kosovo
Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Opština Ranilug
Komuna e Ranillugut
Municipality of Ranilug



Në bazë të nenit 11, neni 12, paragrafi 12.2 pika (d) dhe neni 17 pika (s), Ligji për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Neni 8 pika (p), neni 15, paragrafi 15.1 i Statutit të Komunës Ranillug Nr. 02-154/2011, Kuvendi i Komunës së Ranillugut në seancën e mbajtur më 28.06.2020 miratoi:

V E N D I M I N
MBI ZBATIMIN E PUNËVE TË KORRJEVEO NË TERRITORIN E KOMUNËS SË
RANILLUGUT PËR VITIN 2020

1.

Propozimi i propozuar kaloi shqyrtimin kryesor në seancën e Kuvendit të mbajtur më 28.06.2020, ku u lejua dhe u miratua me shumicë votash.

2.

Miratimi i këtij vendimi përcakton kushtet dhe kriteret themelore për zbatimin e punimeve të korrjes, si dhe formimin e Komisionit për monitorimin dhe vlerësimin e punimeve të korrjes në Komunën e Ranillugut për vitin 2020, në zbatim të Rregullores për zbatimin e punimeve të korrjes në Komunën e Ranilug, nr.02-052/2011 sipas të cilit përcaktohet çmimi, kushtet për kombajnerët, plotësimi i kushteve për korrje të kombajnerëve dhe detyra e Komisionit.

3.

Komisioni për monitorimin dhe vlerësimin e punimeve të korrjeve të Komunës Ranillug do të formohet në përbërjen e mëposhtme:

1. Negovan Antić - kryetar i Komisionit.
2. Goran Artonović-anëtar.
3. Aleksandar Stojanović-anëtar.
4. Bojan Jevtić-anëtar.

4.

Departamenti i Bujqësisë dhe Pylltarisë dhe Komisioni për Monitorimin dhe Vlerësimin e Punëve të Korrjeve të Komunës së Ranillugut do të kujdesen për zbatimin e këtij vendimi.

5.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi Komunal.

Datë: 28.06.2020.

Ranillug

Përktheu: Lazim Bajrami



Kryesuesi i K.K të Ranillugut

Bojan Jovanović